Energji Ashta Sh.p.k

Raporti i Ecurisë së Veprimtarisë dhe I Drejtimit të Brendshëm

2021

Permbajtja

Pershkrimi i Shoqerise 2
Vlerat 4
Qendrushmeria 4
Strategjia 5
Qellimet Strategjike 5
Ecuria Financiare 5
Vijmesia 7
Administrimi i Riskut 7
Qendrueshmeria 10
Informacion Shpjegues Social 11
Informacion Social dhe Mjedisor 14
Informacion Ekonomik 15

Raporti i Ecurisë së Veprimtarisë
Përshkrim i shoqërisë

Energji Ashta Shpk regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me numër unik identifikimi NUIS K82417005V.Zyrat qëndore të kompanisë ndodhen në Ashtë ,fshati Spatharë,Bushat,Bashkia e Vau të Dejës,Shkodër Shqipëri.

Energji Ashta Shpk (´EA`) është themeluar specifikisht për ndërtimin, operimin dhe financimin e centralit të energjisë hidroelektrike të Ashtës ("HEPP"). Hidrocentrali përmirëson furnizimin me energji në Shqipëri dhe ndihmon në zvogëlimin e varësisë së vendit nga importet e energjisë elektrike. Ai është planifikuar në pajtim me standardet mjedisore dhe nuk shkakton ndotje. Pas një periudhe koncesioni 35-vjeçare, hidrocentrali do t'i transferohet Republikës së Shqipërisë.

Hidrocentrali i Ashtës ndodhet në veri të Shqipërisë pranë Shkodrës, qyteti i katërt më i madh në vend. Hidrocentrali është i ndarë në dy pjesë: Ashta 1 fillimisht prodhon energji elektrike, pikërisht atje ku rezervuari i Spatharës me digën e tij rrjedhëse dhe sistemin e ujitjes janë ngritur tre dekada më parë për industrinë bujqësore. Pastaj, në fund të kilometrit të 5-të, kanalet e ulëta kalojnë afër fshatit Ashta dhe këtu energjia elektrike prodhohet këtë herë nga Ashta 2. Kapaciteti i kombinuar i të dy hidrocentraleve (Ashta 1 dhe Ashta 2) është 53 megavat (MW); 242 milionë kilovat orë prodhohen në vit.

HEPP Ashta ka krijuar vende të reja pune dhe ka dhënë një impuls pozitiv në rajon dhe në vend. Energjia elektrike ka qenë një temë e nxehtë për Shqipërinë, ndërtimi i këtij hidrocentrali garanton furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike të rrjetit të energjisë elektrike në Shqipëri, redukton importet e energjisë nga jashtë vendit dhe ndikon në mënyrë të moderuar në mjedis. Në të vërtetë, ndikimi mjedisor i projektit është pothuajse i papërfillshëm, veçanërisht pasi hidrocentralet nuk shkaktojnë asnjë ndotje.

Për më tepër, hidrocentrali Ashta është një risi botërore: ai është hidrocentrali më i madh në botë që funksionon me teknologjinë matricë. Teknologjia e Hydro-Matrix (një turbinë e vogël afërsisht me madhësi thuajse sa një kuti telefonike) mundëson një shfrytëzim efikas të ujit.

Raporti Vjetor 2021

Duke filluar nga viti 2020, EA publikon pasqyrat financiare vjetore dhe Raportin e Ecurisë së Veprimtarisë dhe i Drejtimit të Brendshëm në faqen e internetit të Kompanise. Çdo vit, EA dorëzon këto dokumente në Qendrën Kombëtare të Biznesit në Shqipëri.

EA thekson komunikimin transparent me të gjithë palët e interesuara. Informacioni që shoqëria i ofron aksionarit të saj dhe palëve të tjera të interesuara duhet të sigurojë detaje të mjaftueshme për të lejuar një vlerësim të vlerave themelore të shoqërisë dhe ekspozimit ndaj rrezikut.

Raporti i Ecurisë së Veprimtarisë dhe i Drejtimit të Brendshëm është përgatitur gjithashtu në përputhje me nenet nr. 17 dhe nr. 19 të Ligjit për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare nr. 25/2018, datë 10.05.2018. Raporti është aprovuar nga Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme dhe është nënshkruar ne emër të tij nga:

Peter Stelzer
Administrator

Peter Loidl
Administrator

VLERAT

Ne punojmë bashkarisht drejt qëllimeve të përbashkëta.
Ne jemi autentikë në bashkëveprimet tona dhe komunikojmë hapur, sinqerisht dhe me respekt.
Ne ofrojm rezultatet me te mira te mundshme per klientin dhe krenohemi per punen tone te ngritur mbi cilesine dhe integritetin.

QËNDRUESHMËRIA

Në EA, qëndrueshmëria është mënyra se si ne menaxhojmë dhe operojmë biznesin tonë për t'i shërbyer sa më mirë klientit tonë, për t'u kujdesur për mjedisin, për të siguruar fitime dhe për të nxitur të ardhme afatgjatë.

Qëndrueshmëria është një metodë biznesi që siguron siguri, efikasitet dhe përgjegjësi në një mënyrë që mbron punonjësit e EA, komunitetet, aksionarët dhe mjedisin, tani dhe në të ardhmen.

Operacionet tona të përditshme përafrojnë performancën e biznesit me një përkushtim ndaj administrimit të mjedisit, shoqërisë dhe komunitetit, duke përfshirë tre elementë:

- Ulja e efekteve ne mjedis gjatë operacioneve tona.
- Angazhohemi hapur në çështjet e qëndrueshmërisë.
- Mbështetim zhvillimin e qëndrueshëm.

o COVID- 19

Fokusi kryesor ka qenë për të garantuar sigurinë dhe shëndetin e punonjësve tanë në të gjitha operimet tona. Aspekt tjetër i rëndësishëm ka qenë ndjekja e ecurisë me furnitorët tanë. Fokus tjetër ka qenë në kuptimin se si pandemia mund të ndikojë në angazhimin tonë me komunitetin, në aspekte si programet me komunitetet vendore.
Veprimet e ndërmarra përfshijnë përforcimin e partneritetit ekzistues, për të trajtuar nevojat që kanë lindur si pasojë e pandemisë.

STRATEGJIA

o Zhvillimi i tregut

EA, si pjesë e Grupit VERBUND integron strategjinë dhe praktikat në lidhje me përqasjen ndaj Tregut. Viti 2021 ka qenë vit i pazakontë, me rënie ekonomike në shkallë botërore prej Covid-19. Megjithatë, viti 2021 nuk ka frenuar zhvillimin e shpejtë të energjive të rinovueshme. Energjia e rinovueshme ishte i vetmi burim energjie që përjetoi rritje gjatë vitit 2021 dhe sektori energjetik ka qenë nga sektorët më të fortë deri më tani.

Megjithëse pandemia ka shkaktuar çrregullim të tregut në afat të shkurtër, trendët makro në afat të gjatë mbeten të vlefshme. Vazhdojnë zhvillohen vëllime të mëdha të energjisë së rinovueshme, që rrit nevojën për prodhim fleksibël. Klientët kanë interes më të lartë ndaj energjive të rinovueshme dhe aksesi në energji të lirë e të pastër e bën elektrifikimin zgjidhjen më efektive ndaj ndryshimeve klimatike. Strategjia e korporatës së VERBUND ka si qëllim të përgjigjet ndaj këtyre zhvillimeve.

o Pozicioni konkurrues i VERBUND dhe EVN

Grupi VERBUND dhe EVN ka një themel të fortë për rritje të mëtejshme.

o Një përqasje e përqendruar tek tregu

Pronarët e EA do të vazhdonjë të ndjeke një përqasje të përqendruar tek tregu. Kjo nënkupton ndërtimin mbi kuptimin e thelluar të tregut që ka për të gjetur mundësitë më të mira në energjinë e rinovueshme në çdo treg dhe në teknologji të ndryshme. Ndryshimet e shpejta në tregjet e energjisë kërkojnë fleksibilitet në synimet dhe mundësitë e ndjekura. Kompania monitoron në mënyrë të vazhdueshme tregun dhe zhvillimet teknologjike për të identifikuar rreziqet e biznesit dhe mundësitë që lindin.

Prioritetet strategjike

Optimizimi dhe përhapja e energjisë hidrike
Nevoja për fleksibilitet në tregjet e energjisë rrit dhe mundëson një pikënisje unike për një gjenerues fleksibël të energjisë hidrike me ekspertizë tregu.EA është e angazhuar me grupet e interesit për të gjetur zgjidhje të cilat balancojnë nevojat mjedisore dhe shoqërore me përfitueshmërinë.

Zhvillimi i biznesit të ri
EA është duke parë në mënyrë të vazhdueshme mundësitë e reja ku kapacitetet ekzistuese dhe portofoli mund të japin një avantazh konkurrues.

Ambicia e Energji Ashta për 2030

EA synon të jetë një shoqëri e fortë e energjisë nga burime të rinovueshme, me operacione të qëndrueshme, etike dhe të sigurta.

QËLLIMET STRATEGJIKE

Manaxhimi ka caktuar qëllime financiare dhe jo-financiare për EA. Ecuria e lidhur me disa nga synimet do të vlerësohet në një hark kohor më të gjatë. Kujdesi për njerëzit është në bazë të veprimtarisë së EA dhe EA punon vazhdimisht drejt synimit prej zero lëndime. Nuk ka pasur aksidente fatale në 2021.
EA ka tolerancë zero për korrupsionin dhe praktikat jo-etike në të gjitha veprimtaritë, dhe nuk ka pasur incidente të pajtueshmërisë në 2021.
Vlerësimi i rreziqeve mjedisore është pjesë e procedurave dhe praktikave të përditshme të administrimit të rrezikut të EA dhe nuk ka pasur incidente serioze mjedisore në 2021.

ECURIA FINANCIARE

Gjatë vitit 2021 prodhimi total ishte 295,261 MWh.Në fund të vitit 2021, kapitali i Shoqërisë ishte 7,412,553,755 Lekë.Zërat e paraqitur më poshtë janë matës alternative të ecurisë. Elementët nga pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse pas fitimit operativ janë analizuar në përputhje me pasqyrat financiare.

Të ardhurat neto nga shfrytëzimi

Të ardhurat e Energji Ashta gjenerohen nga shitjet.Baza themelore për të ardhurat e Energji Ashta përbëhet nga prodhimi.

Te ardhurat-ndryshimi nga 2020-2021
(ne mije leke)

Shpenzimet operative

Në total, shpenzimet operative të Shoqërisë kanë rënë me 8,17% krahasuar me një vit më parë.

Shpenzimet operative-ndryshimi nga 2020-2021
(ne mije leke)

Zërat financiarë

Zërat financiarë përbëhen kryesisht nga humbjet neto prej kurseve të këmbimit dhe shpenzimet e interesit. Efekti negativ është kryesisht i lidhur me të pagueshmet në valutë të huaj dhe si rezultat i një fuqizimi të Lekut ndaj Euros.

Shpenzimi i tatim fitimit

EA ka regjistruar fitim neto për vitin 2021 prej 867,058,123 Lekë. Duke qenë se kompania ka humbje tatimore të mbartura, nuk kishte asnjë detyrim për të paguar Tatim mbi Fitimin.

Flukset monetare

Flukset monetare nga aktivitetet operative ishin 1,307,888 mijë lekë. Rritja erdhi kryesisht si rezultat shlyerjes së të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve të Shoqërisë. Flukset monetare nga aktivitetet e financimit ishin në shumën prej (1,151,108) mijë Lekë dhe ishin të lidhura me pagesat e kredise. Fluksi i parasë nga aktivitetet investuese prej (3,884) mijë lekë lidhej kryesisht me investimet në aktive materiale. Në fund të vitit, mjetet monetare dhe ekuivalentet me to ishin në shumën e 226,794 mijë Lekë.

Flukset monetare
(ne mije leke)

VIJIMËSIA

Në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), Bordi i Drejtorëve konfirmon që pasqyrat financiare vjetore janë përgatitur me supozimin që shoqëria do ketë vijimësi, dhe se ky supozim është i saktë.

ADMINISTRIMI I RREZIKUT

EA është e ekspozuar ndaj rreziqeve përgjatë zinxhirit të vlerës. Rreziqet më të rëndësishme janë të lidhura me Shëndetin, Sigurinë, Mbrojtjen dhe Mjedisin,çmimin, rrezikun financiar, projektet e ndërtimit dhe aktivitetet e shfrytëzimit si dhe rreziqet politike.

Administrimi i rrezikut është pjesë e integruar e modelit të drejtimit të EA. Shoqëria ka një përqasje të bazuar në rrezik në përcaktimin e synimeve, prioriteteve dhe ndjekjen në fushën e biznesit dhe stafit. Administrimi i përditshëm i rrezikut është një përgjegjësi e vijueshme. Rreziqet e përgjithshme të Shoqërisë rishikohen dhe ndiqen nga Manaxhimi i Shoqërisë dhe raportohen në Komisionin e Aksionerëve.

Manaxhimi shoqërisë ka përgjegjësinë e përgjithshme për hartimin dhe mbikëqyrjen e kuadrit të administrimit të rrezikut të Shoqërisë. Politikat e administrimit të rrezikut të Shoqërisë janë hartuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga Shoqëria, për të vendosur kontrollet dhe limitet e duhura të rrezikut dhe për të monitoruar rrezikun dhe respektimin e limiteve.
Politikat dhe sistemet e administrimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, nëpërmjet standardeve dhe procedurave të saj dhe drejtimit synon të mbajë një mjedis të disiplinuar dhe konstruktiv të kontrollit në të cilin të gjithë punonjësit janë në dijeni për rolet dhe detyrimet e tyre.

- ### Rreziku i aktivitetit

Të gjitha proceset përgjatë zinxhirit të vlerës janë të ekspozuara ndaj rrezikut të aktivitetit. Rreziku i aktivitetit është më i lartë në, aktiviteteve të shfrytëzimit dhe të mirëmbajtës si dhe aktiviteteve të tregut. Kjo mund të sjellë:
• Dëmtime tek punonjësit, kontraktorët dhe palët e treta
• Dëmtime në mjedis
• Shkelje të pajtueshmërisë
• Dëmtim dhe humbje të centraleve tona të prodhimit dhe të palëve të treta dhe të aktiveve të tjera
• Reputacion i dobësuar
• Humbje financiare

Prioriteti kryesor i EA është të sillet në një mënyrë të qëndrueshme, etike dhe të përgjegjshme nga pikëpamja shoqërore dhe të pajtohet me të gjitha kërkesat ligjore kudo ku kompania kryen aktivitet. EA i kushton një vëmendje të madhe kryerjes së aktiviteteve të zhvillimit dhe shfrytëzimit në një mënyrë të përgjegjshme dhe shmangies së humbjeve. Një kulturë e fortë biznesi është themeli i përmirësimit të vazhdueshëm të një sistemi të shëndoshë parandalimi dhe kontrolli. Sigurimi se aktivitetet e zhvillimit të biznesit janë në përputhje me standardet ndërkombëtare ka një prioritet të lartë. Rreziku i aktivitetit administrohet përmes procedurave dhe kontrolleve të aktiviteteve dhe proceseve, duke projektuar zgjidhje teknike, zhvilluar kompetencat dhe në llojet e ndryshme të planeve rezervë.

Për më tepër, EA ka një sistem gjithëpërfshirës për regjistrimin dhe raportimin e rrezikut, kushtet e rrezikshme, incidentet e padëshirueshme, dëmtimet dhe lëndimet. Të tilla raste analizohen vazhdimisht në mënyrë që të parandalohet dhe të kufizohet çdo pasojë negative, dhe të sigurohet që mund të ndjekim shkaqet dhe të marrim masat e nevojshme.
Rreziku kibernetik po rritet në të gjithë botën. Infrastruktura e EA dhe aplikacionet janë të ekspozuara ndaj sulmeve të jashtme. Procedurat, kompetencat dhe sistemet përmirësohen në mënyrë të vazhdueshme për të forcuar qëndrueshmërinë përballë incidenteve të tilla.

EA kryen vazhdimisht vlerësime të rrezikut. Zbatimi I administrimit të rrezikut në fazat e hershme të zhvillimit të biznesit dhe projektit është një faktor i rëndësishëm i suksesit. Pasojat e mundshme financiare të rrezikut total të aktivitetit, si dhe rreziqe të rëndësishme individuale, janë tregues kryesorë të profilit të rrezikut të përgjithshëm të Shoqërisë. EA ka mbulim nga sigurimi për të gjitha rastet e rëndësishme të dëmtimeve ose lëndimeve nga aktiviteti.

- ## Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku i ndryshimit të çmimeve të tregut,të tilla si çmimi i energjisë elektrike, normat e interesit, normat e këmbimit dhe çmimet e kapitalit që do të ndikojnë në të ardhurat e Shoqërisë ose vlerën e instrumenteve financiare të zotëruara. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të administrojë dhe kontrollojë ekspozimin ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm duke maksimizuar kthimin.

i. Rreziku I cmimit

Risku i tregut lind kur një shoqëri është subjekt i kushteve të pafavorshme të shitjes për shkak të rritjes së konkurrencës në treg, destabilitetit të tregut dhe paaftësisë për pozicionim në treg të produkteve ose shërbimeve. Risku i tregut mund të ndahet në dy komponentë: risku i volumit të shitjes dhe riskut të çmimeve. Risku i volumit të shitjes i referohet luhatjeve në volumin e shitjeve në treg dhe risku i çmimit i referohet luhatjeve në nivelet e çmimeve.

Shoqëria nuk është e ekspozuar ndaj riskut të çmimeve pergjate vitit 2021 sepse ajo shet energji elektrike me një çmim fiks. Nga ana tjetër, shoqëria mbart risqe të volumit, sepse energjia elektrike e prodhuar, në masë të madhe varet nga kushtet e motit.

Çmimi për shitjen e energjisë ka qënë 5.9 cent EUR/kWh, dhe do të ketë efekt për një periudhë prej 15 vjetësh nga data e përfundimit të ndërtimit. Çmimi për shitjen e energjisë është i indeksuar në baza tremujore.Pasi të kenë kaluar 15 vitet, palët do të kenë të drejtë të rinegociojnë çmimin e përcaktuar në marrëveshjen për shitjen e energjisë elektrike. Nëse nuk arrihet asnjë marrëveshje mes KESH sh.a. dhe EA, kjo e fundit do të ketë të drejtën për të shitur të gjithë prodhimin neto të energjisë elektrike ndaj palëve të treta në një treg të hapur. Nga ana tjetër, KESH sh.a do të rregullojë një çmim të ri të energjisë elektrike i cila reflekton pozitën e përmirësuar ekonomike të EA në tregun e hapur, si një shitës i aftë për të hyrë në marrëveshje me të tretë.

ii. Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit lidhur me ndryshimet e mundshme në normat e kurseve të këmbimit për sa i përket transaksioneve të saj në monedhë të huaj. Shoqëria disponon balanca të konsiderueshme në Euro si detyrim ndaj furnitorëve të saj, gjë që ekspozon Shoqërinë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Shoqëria disponon balanca të konsiderueshme në Euro të mjeteve monetare dhe ekuivalentet e tyre që maturohen në të njëjtën periudhë në të cilën duhet të shlyhen detyrimet tregtare. Portofoli rregullohet vazhdimisht në lidhje me perceptimet e përditësuara të çmimeve të ardhshme dhe kapacitetit gjenerues të vetë Shoqërisë.

o Rreziku financiar

Rreziku financiar i lidhur me valutat e huaja, normat e interesit, likuiditetin dhe financimin koordinohet dhe administrohet në nivel grupi.

i. Rreziku i kreditimit

Rreziku i kreditimit është rreziku i një humbje financiare nga Shoqëria në rast se një klient apo një palë në një instrument financiar nuk përmbush detyrimet kontraktuale dhe krijohet kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë.

ii. Llogaritë e arkëtueshme

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kreditimit është influencuar kryesisht nga klienti I vetem. Marreveshja e Koncensionit ka te rregulluar dhe garanton marredhenien me Autoritetin kontraktues. Shoqëria kufizon ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kreditimit nga llogaritë e arkëtueshme duke vendosur një afat 30 ditor për faturat mujore. Klienti i vetem i Shoqërisë kryen transaksione me Shoqërinë prej vitit 2013, dhe asnjë balancë nuk është çregjistruar ose zhvlerësuar në datën e raportimit.

iii. *Risku i huasë*

Një risk huaje është risku i mospagimit të borxhit që mund të lindë nga një huamarrës që dështon për të bërë pagesat e kërkuara. Risku i huasë mbartet nga huadhënësi. Për të reduktuar riskun e huasë, huadhënësi mund të kryejë kontrolle të cilat janë reflektuar në normën e interesit ose mund të kërkojë nga huamarrësi garanci hipotekare apo garanci nga një palë e tretë. Ekzistenca e një garancie zvogëlon riskun e huasë dhe ia kalon riskun garantuesit.

Në rastin tonë, duket se risku i huasë i përket huadhënësit, por duke pasur parasysh se ka një garanci nga VHP dhe EVN, mund të themi se risku në rast të mospagimit nga EA, mbartet nga VHP dhe EVN.

EA është në pronësi të Ashta Beteiligungsverwaltung GmbH, e cila zotërohet 50,01% nga VERBUND Hydro Power GmbH ("VHP") dhe 49,99% nga evn naturkraft Erzeugungsgesellschaft m.b.H.

evn naturkraft Erzeugungsgesellschaft m.b.H është një degë 100% e EVN AG ("EVN"), një kompani lider, ndërkombëtare dhe e listuar publikisht për shërbimet e energjisë dhe mjedisit, me seli në Austrinë e Ulët, provincën më të madhe federale të vendit.
Bazuar në infrastrukturën më moderne, EVN furnizon tregun e saj vendas me energji elektrike, gaz natyror, ngrohje, ujë të pijshëm dhe trajtim të ujërave të zeza, djegie të mbeturinave dhe shërbime të ngjashme nga një furnizues i vetëm. Për më tepër, kompania operon rrjete televizive kabllore dhe telekomunikuese dhe ofron shërbime të ndryshme energjetike për klientët privatë dhe biznesorë si dhe komunat si pjesë e portofolit të saj.
Në total, EVN aktualisht është aktive në 14 vende. Pjesa e të ardhurave të Grupit të gjeneruar jashtë Austrisë arriti në 51.4% gjatë vitit financiar 2019/20 (viti i mëparshëm: 44.4%).

VHP është një filial 80,54% i VERBUND, kompania lider energjetike e Austrisë dhe një nga prodhuesit më të mëdhenj të energjisë hidroelektrike në Evropë. Grupi gjeneron rreth 95% të energjisë elektrike nga energjia e rinovueshme, kryesisht nga hidrocentralet. VERBUND tregton energji elektrike në 12 vende dhe gjeneroi rreth 3.2 miliardë euro të ardhura vjetore në vitin 2020 me rreth 2,900 punonjës.
VERBUND është një nga kompanitë energjetike më miqësore me mjedisin në Evropë, kontribuon ndjeshëm në sigurinë e furnizimit dhe është veçanërisht e përkushtuar për mbrojtjen e klimës dhe mjedisit, përdorimin e kujdesshëm të burimeve dhe përgjegjësinë sociale. Qëndrueshmëria është një pjesë thelbësore e strategjisë së korporatës. VERBUND po punon intensivisht në zgjerimin e burimeve të rinovueshme të energjisë dhe në këtë mënyrë po jep një kontribut të rëndësishëm në një të ardhme energjie me karbon të ulët.

o Rreziku rregullator dhe i vendndodhjes

Aktivitetet e EA në Shqipëri janë të ndikuara nga kushtet kufizuese të tilla si tarifat, kushtet për koncesionin, rregulloret dhe kërkesat për rrjetet e energjisë dhe përcaktimet e vendosura nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Rreziku I ndryshimeve legjislative mund të sjellë gjoba, kufizime dhe/ose humbje të mundësive duke ndikuar në zbatimin e projektit dhe prodhimin e EA, kostot dhe të ardhurat. EA bën përpjekje të qenësishme në analizimin se cilat mund të jenë efektet e mundshme në fushën në të cilën operon dhe vazhdimisht ndërmerr veprime për zvogëlimin e rrezikut.

EA është gjithashtu e ekspozuar drejtpërdrejtë ndaj kushteve të kuadrit legjislativ të tilla si shkallët e taksimit, kushtet e licencave dhe rregullave publike. Rreziku i ndryshimeve të mundshme në kuadrin politik mund të sjellë një mjedis më sfidues biznesi çka do të përkthehej në mos përmbushjen e afateve e shoqëruar edhe me humbje financiare. Si pasojë EA thekson rëndësinë e ndjekjes së zhvillimeve të këtyre faktorëve dhe po merr masa në koordinim me drejtimin e palëve të interesuara.

Shqipëria konsiderohet një treg në zhvillim çka e ekspozon EA ndaj një rreziku të konsiderueshëm të vendndodhjes. Një proces i zakonshëm i vlerësimit të rrezikut është zbatuar për të siguruar një administrim gjithëpërfshirës dhe proaktiv të rrezikut të biznesit. Vlerësimi i rrezikut mbulon aspekte politike dhe ligjore, zhvillimin shoqëror, sigurinë, pajtueshmërinë, regjimin tatimor dhe legjislacionin për biznesin. EA ndjek në mënyrë të rreptë standardet e VERBUND dhe ka implementuar një sistem për të siguruar pajtueshmërinë në të gjitha veprimtaritë dhe ka zero tolerancë ndaj korrupsionit. EA monitoron ne mënyrë te vazhdueshme zhvillimin e tregut te energjisë ne rajon ne mënyrë qe te përshtatet me zhvillimet përkatëse, ne përputhje me kërkesat dhe praktikat e VERBUND.

Qëndrueshmëria

o Përqasja jonë ndaj qëndrueshmërisë

EA si pjesë e grupit VERBUND është e angazhuar në praktika të qëndrueshme biznesi dhe në luftën kundër ndryshimeve klimatike. Grupi VERBUND ushtron biznes globalisht, dhe vizioni jonë është të ofrojmë energji të pastër. Energjia që ne prodhojmë është përmes burimeve të ujit. Strategjia e biznesit të EA është e bazuar në zhvillimin e veprimtarisë në mënyrë të sigurt, etike dhe të përgjegjshme. Përqasja jonë ndaj qëndrueshmërisë është në ndryshim të vazhdueshëm, së bashku me strategjinë e biznesit dhe zhvillimet ndërkombëtare. EA si pjesë e grupit VERBUND është e udhëhequr nga kuadri ndërkombëtar, të tilla si Rregullorja e OECD për Sipërmarrjet Shumëkombëshe dhe Parimet Udhëheqëse të Kombeve të Bashkuara mbi Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut.

EA angazhohet për të ofruar një shërbim cilësor në një mënyrë që siguron një vend pune të sigurt dhe të shëndetshëm për punonjësit tanë dhe te minimizoje ndikimin tonë të mundshëm në mjedis.
EA gjithashtu njeh dhe pranon përgjegjësinë e saj për të kryer biznesin e saj në përputhje me të gjithë legjislacionin përkatës mjedisor dhe do të përpiqet të përdorë praktikat më të mira mjedisore në të gjitha aktivitetet e saj.

Pra, politika jonë mjedisore është të:

- të integrojë shqyrtimin e shqetësimeve dhe ndikimeve mjedisore në vendimmarrjen dhe aktivitetet e saj
- menaxhimi i vazhdueshëm i rrjedhës së duhur ekologjike të ujit dhe i kanalit të kalimit të peshkut për të mbrojtur jetën ujore dhe kafshëve të egra sipas marrëveshjeve dhe ligjeve në fuqi
- monitorimin e vazhdueshëm të ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore
- minimizimin e mbetjeve të saj dhe menaxhimin e vazhdueshëm të mbetjeve të grumbulluara nga lumi
- minimizimi i përdorimit të energjisë dhe ujit brenda ndërtesave tona në mënyrë që të ruhen furnizimet dhe për të minimizuar konsumin e burimeve natyrore
- trajnim, edukim dhe informim i punonjësve tanë për çështjet mjedisore që mund të ndikojnë në punën e tyre
- të promovojë vetëdijen mjedisore për banorët e zonave përreth dhe midis punonjësve tanë dhe t'i inkurajojë ata të punojnë në mënyrë të përgjegjshme për mjedisin
- komunikimin e angazhimin tonë mjedisor ndaj klientëve, klientëve dhe publikut dhe inkurajojmë ata që ta mbështesin atë
- kur kërkohet nga legjislacioni ose ku ekzistojnë rreziqe të konsiderueshme shëndetësore, sigurie ose mjedisore, zhvillojnë dhe mbajnë procedurat e duhura
- rishikimi i politikës tonë mjedisore çdo vit në konsultim me stafin, bashkëpunëtorët dhe klientët

Sikurse përparimet e teknologjisë dhe rregulloret ndryshojnë, EA do të vazhdojë të përmirësojë sistemet, të zvogëlojë mbetjet dhe të shfrytëzojë në mënyrë efikase burimet për të përmbushur sfidat mjedisore të shekullit të ardhshëm.

Drejtimi

Parimet themelore të EA për sjellje të përgjegjshme janë përshkruar në Kodin e Sjelljes të grupit VERBUND. Kodi zbatohet për të gjitha shoqëritë e grupit VERBUND dhe të gjithë individët të cilët punojnë për këto shoqëri. Partnerët tanë të biznesit pritet t'i përmbahen standardeve në përputhje me Kodin e Sjelljes së Furnitorëve të VERBUND.

Sistemi i drejtimit të EA cakton ambiciet, udhëzimet dhe kërkesa të tjera të detajuara. Sistemi rishikohet rregullisht për ta përshtatur me pritshmëritë e reja dhe sfidat. Kërkesat e qëndrueshmërisë dhe rregulloret janë të përfshira në projektet e ndërtimit. Gjithashtu kemi një sistem për regjistrimin dhe ndjekjen e mospajtueshmërisë me kërkesat e brendshme dhe të jashtme. Sistemi lehtëson administrimin e çështjeve, analizën e incidenteve, identifikimin e përmirësimeve, dhe mësimin e vazhdueshëm në Shoqëri.

Dialogu me palët e interesuara

EA synon të ketë një dialog të hapur mbi çështjet e qëndrueshmërisë me palët e interesuara të ndikuara nga veprimtaria jonë. Palë të interesuara të rëndësishme në këto biseda përfshijnë zyrtarët shtetërorë, autoritetet lokale dhe rajonale, komunitetet lokale, punonjësit, klientët, furnitorët, institucionet kërkimore, organizatat jo-qeveritare, organizatat vullnetare dhe median.
Dialogu me palët e interesuara është pjesë e veprimtarive ditore, duke filluar nga ndërveprimi i zakonshëm me palët e interesuara në vendndodhjet e projekteve tona.

Kontributi i Energji Ashta

Pjesa më e madhe e emetimeve të gazrave në botë janë të lidhura me energjinë. Kështu rritja e prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme është kritike në mënyrë që të arrihen synimet e emetimeve globale. Për më tepër, elektrifikimi i bazuar në energjinë e rinovueshme është një element kryesor për të luftuar ndryshimet klimaterike. EA është pjesë e zgjidhjes për një botë me energji të pastër.

Aktivitetet e EA kontribuojnë në mënyra të ndryshme në ekonomitë globale, kombëtare dhe lokale përmes ndarjes së dividendëve për aksionerët, taksat e paguara ndaj qeverive, punësimit direkt, dhe aktiviteteve lokale të prokurimit, dhe investimeve sociale. Përqasja jonë për sjelljen e përgjegjshme të biznesit kontribuon në promovimin e praktikave të mira të biznesit. Ne gjithashtu kërkojmë të ndajmë njohuritë rreth energjisë së rinovueshme, sistemeve të energjisë, ndryshimeve klimaterike dhe çështjeve mjedisore.

Gjenerimi i energjisë prej EA realizohet nga burime të rinovueshme (ujore). Energjia e ujit ka shume avantazhe, duke përfshirë efiçencën e lartë, kostot e ulëta të shfrytëzimit, jetëgjatësinë, fleksibilitetin e lartë dhe intensitetin e ulët të karbonit.
Zhvillimi dhe shfrytëzimi i hidrocentraleve lehtëson përdorimet e shumta të rrjedhave ujore dhe infrastrukturës për shembull ujitjen, furnizimin me ujë të pijshëm, transportin dhe zbavitjen. Për më tepër, përdorimi i rezervuarëve për kontrollin e përmbytjeve bëhet akoma më i rëndësishëm teksa klima ndryshon. Shoqëria gjithashtu kontribuon për përdorim më optimal të burimeve të energjisë përmes kontrollit të aktiveve të rinovueshme.

Një Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM) është përgatitur për projektin. Një analizë solide e vendeve të mundshme të projektit është përfshirë në VNM, ku International Finance Corporation (IFC) është përfshirë gjithashtu në zgjedhjen e vendit. Në krahasim me alternativat e tjera, ky projekt është zgjedhur për shkak se:

- mban një përmbytje shumë minimale të tokës së punueshme;
- ka gjatësinë më të shkurtër të kanalit, duke prekur një pjesë të vogël të lumit Drin i cili është më i varfër dhe më pak i vlefshëm në habitat dhe biodiversitet se pjesë të tjera;
- nuk ndikon zonat e mbrojtura dhe kulturore të trashëgimisë historike;
- nuk ndikon në ekosistemin e Liqenit të Shkodrës;
- nuk ndikojnë në sasinë dhe cilësinë e ujërave nëntokësore;
- respekton shqetësimet mjedisore për lirimin minimal të ujit ekologjik në shtratin e lumit ekzistues (të miratuar në 10% të rrjedhës së ujit).

Shumica e ndikimeve mjedisore të digave ekzistuese dhe një barriere të ndërtuar në kaskadën e lumit Drin kanë ndodhur gjatë këtyre 40 viteve.

INFORMACION SHPJEGUES SOCIAL

Shëndeti dhe Siguria

- **Përqasja jonë**

Kujdesi për njerëzit është baza e kulturës së EA dhe ne punojmë vazhdimisht drejt qëllimit tonë prej zero lëndime. EA ka një program për të zbatuar përmirësimet në shëndetin dhe sigurinë e të gjithë organizatës. Drejtimi i korporatës së EA demonstron qartë angazhimin e tyre për një mjedis pune pa lëndime dhe dëmtime.

- **Rreziqet kryesore**

Rreziqet e lidhura me shëndetin dhe sigurinë vijnë nga veprimtaritë e EA në projekte ndërtimi, shfrytëzim dhe mirëmbajtje e centraleve dhe pajisjeve të tjera. Fushat mbizotëruese me rrezik të lartë janë të lidhura me lëndimet e personelit nga aksidentet në mjedisin e punës. Veprimtaritë e lidhura me udhëtimin me makinë,punën në lartësi, operacionet e ngritjes, sistemet e energjisë, pajisjet e rënda të lëvizshme, punët në tokë dhe të punuarit në hapësira të mbyllura konsiderohen të kenë rrezikshmërinë më të lartë.

- **Statusi 2021**

Në vitin 2021,treguesi ishte 0 lendime për punonjësit e EA.

- **Trajnimet për shëndetin dhe sigurinë**

Kompetenca e përshtatshme është një parakusht për një kulturë të fortë shëndeti dhe sigurie. Punonjësve të EA u sigurohen trajnime sipas nevojave individuale dhe situatës së punës. Janë të mundura trajnime të përshtatshme për qëllimin e grupeve të synimeve të ndryshme.

- **Siguria e palëve të treta**

Veprimtaritë e EA kërkojnë ndërveprim të theksuar me palët e treta dhe ne jemi të fokusuar në mundësimin e sigurisë së tyre.Siguria e HEPP është një fushë kryesore ku ne fokusohemi. Masat merren në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore. EA bën mirëmbajtje në HEPP dhe strukturat e lidhura nëpërmjet një sistemi strikt dhe të kontrolluar. Shoqëria ka zhvilluar procedura të detajuara dhe plane dhe kështu siguron që këto struktura nuk përbëjnë një kërcënim për jetën, pronën apo mjedisin.

- **Përqasja jonë**

EA ka një përqasje gjithëpërfshirëse dhe ndjek praktikat më të mira ndërkombëtare për administrimin e sigurisë. Siguria I referohet aftësisë për të mbajtur njerëzit, operacionet, informacionet dhe sistemet të mbrojtura nga dëmtimet e qëllimshme. Çështjet e sigurisë adresohen përmes një përqasje të bazuar në rrezik. Siguria e informacionit ka një prioritet të lartë dhe EA ndjek praktikat më të mira ndërkombëtare për administrimin e sigurisë së informacionit.

Qëllimi është të ndërtojë dhe në mënyrë të vazhdueshme të përmirësojë një kulturë të fortë të sigurisë së informacionit që siguron konfidencialitet, integritet dhe disponueshmëri të informacionit të EA. Përgjatë 2021, EA ka përjetuar një trend pozitiv në ndërgjegjësimin ndaj sigurisë së informacionit

- **Rreziqet kryesore**

EA vlerëson rreziqet e sigurisë duke analizuar kërcënimet, dobësitë dhe pasojat.
EA përdor një gamë të gjerë masash për të reduktuar rreziqet e sigurisë. Ndryshime të papritura në situatat e sigurisë sjellin masa të menjëhershme.

- **Përgatitja për emergjenca**

Aftësia e EA për të përballuar ngjarje emergjente të padëshiruara dhe serioze është një prioritet i vazhdueshëm. Kjo përqasje synon t'i mundësojë EA të përballojë emergjenca në nivele lokale dhe strategjike.

Statusi në 2021

Për të siguruar ndërgjegjësim të lartë dhe për të shmangur rrezikun e sjelljes, EA informon stafin e saj për ndërgjegjësimin dhe trajnime të lidhur me dilemat në sigurinë e informacionit.

Menaxhimi i Covid-19

Reagimi ndaj Covid-19 ka qenë përpjekja kryesore gjatë vitit 2021. Reagimi është koordinuar globalisht për të garantuar përkujdesje të harmonizuar në përputhje me këshillat dhe udhëzimet lokal të autoriteteve shëndetësore. Strategjia e VERBUND për reagimin ndaj pandemisë ka evoluar rreth parimeve:
• Parandalim i përhapjes dhe mbrojtje e punonjësve, në përputhje me planet kombëtare
• Mirëmbajtje dhe menaxhim i proceseve kritike për shoqërinë – prodhimi i energjisë dhe menaxhimi i ujit

TE DREJTAT E NJERIUT

Përqasja jonë

Puna e EA mbi të drejtat e njeriut, si pjesë e grupit VERBUND, reflektohet në Kodin e Sjelljes së VERBUND. Ky angazhim është I disponueshëm publikisht dhe është komunikuar si brenda dhe jashtë shoqërisë, tek personeli ynë, partnerët e biznesit dhe pa lë të tjera të rëndësishme. Përqasja jonë është të përmirësojmë vazhdimisht dhe të përforcojmë integrimin e të drejtave të njeriut në procese kryesore; të tilla si investimet e reja kapitale.

Rreziqet kryesore

Shqyrtimi me kujdes i të drejtave të njeriut në nivel grupi identifikoi pranueshmërinë e komunitetit lokal, të drejtat e punës,shëndetin dhe sigurinë, dhe marrëveshjet e mbrojtjes si çështje themelore të të drejtave të njeriut për Grupin. Duke ndjekur zhvillimet ndërkombëtare, dhe strategjinë e biznesit të EA, ne jemi duke rishikuar ndikimin tonë në të drejtat e njeriut. Duke u bazuar në rezultatet e marra, ne do të ri-kalibrojmë përqasjen tonë ndaj rreziqeve kryesore atje ku do të shihet e nevojshme. Gjithashtu do të vlerësohen rreziqet kryesore mbi të drejtat e njeriut në zinxhirin e furnizimit.

Statusi në 2021

i. Iniciativat për të drejtat e njeriut

Në vitin 2021, ne vazhduam të simbolizojmë angazhimin tonë në respekt të së drejtave të njeriut në procese kryesore dhe kemi prioritizuar përpjekjet tona lidhur me çështje themelore të të drejtave të njeriut. Një fushë e fokusit tonë ka qene përfshirja e konsideratave mbi të drejtat e njeriut në administrimin e projekteve. Gjithashtu, konsideratat për të drejtat e njeriut u përfshinë në punën lidhur me zinxhirin përgjegjës për furnizimin.

ii. Shkëmbimi i njohurive

Për secilin fazë përkatëse të zhvillimit të projektit janë zhvilluar fushata ndërgjegjësimi mbi veprimtaritë e projekteve.

PRAKTIKAT E PUNES

Përqasja jonë

EA mbështet dhe respekton të drejtat e punës të njohura ndërkombëtarisht duke përfshirë lirinë e shoqërimit dhe njohjen efektive të së drejtës së negocimit kolektiv, ndalimin efektiv të punës së fëmijëve, dhe eliminimin e diskriminimit në lidhje me punësimin dhe profesionin. EA gjithashtu punon për realizimin e këtyre të drejtave si pjese e administrimit të zinxhirit tonë të furnizimit.
Në EA, ne synojmë të krijojmë një mjedis ku punonjësit aktual dhe të ardhshëm mund të mësojnë dhe të rriten. Një mjedis i sigurt i punës dhe mbështetja nga njerëzit rreth nesh është gjithashtu një mundësues për zhvillim.

Rreziqet kryesore

Është me rëndësi të veçantë për EA të tërheqë, zhvillojë, dhe të mbajë njerëzit dhe kompetencën për të arritur qëllimin dhe strategjinë tonë. Lidhur me arritjen e kësaj në një mënyrë të përshtatshme dhe në kohë ka sfida. Ne duhet të sigurohemi se jemi tërheqës si punëdhënës ndaj të gjithë grupeve të specialistëve të fushës. Është gjithashtu e rëndësishme që të zhvillohen punonjësit tanë dhe drejtuesit për të arritur nevojat e kompetencave të ardhshme dhe të mbajmë talentet tona. Iniciativat për të zhvilluar më tej aftësitë e reja dhe kompetencat do të jenë prioritet në te ardhmen.
Përgjegjshmëria është një nga vlerat bërthamë të VERBUND. Fokus kryesor gjatë vitit 2021 ka qenë garantimi I shëndetit dhe sigurisë i njerëzve tanë gjatë pandemisë Covid-19.

Statusi në 2021

Në 2021, ne kemi vijuar me zbatimin e masave për të mbajtur një nivel të lartë të angazhimit të punonjësit dhe të forcojmë më tej zhvillimin e njerëzve. Shembuj të kësaj përfshijnë përpjekje të vazhdueshme për të forcuar kompetencën e drejtuesve për të motivuar, zhvilluar dhe rritur ecurinë e skuadrave të tyre. Përpjekje të mëtejshme për të ndërtuar dhe zgjeruar zhvillimin e drejtimit do të prezantohen në vitet ne vazhdim. VERBUND ofron shume kurse të brendshme, mësime në internet dhe seminare.

Diversiteti i fuqisë punëtore dhe përfshirja

EA kërkon të rrisë diversitetin dhe të nxisë përfshirjen. Ne besojmë se kjo mundëson perspektiva të reja dhe ide që nxisin inovacionin i cili përputhet me nevojat e klientëve tanë dhe shoqërisë. Angazhimi në diversitet dhe përfshirje është i lidhur me të gjitha fushat e diversitetit si p.sh. gjinia, kombësia, prejardhja arsimore, mosha dhe mendësitë. Ne kemi një angazhim të qartë për trajtimin e barabartë dhe toleranca zero për diskriminimin, bullizmin dhe ngacmimin janë parimet themelore të politikave të njerëzve të grupit VERBUND.

MENAXHIMI MJEDISOR DHE SOCIAL

Programi për Administrimin Social dhe Mjedisor-MMS përfshin të gjitha masat lehtësuese sociale dhe mjedisore për Projektin Hidroenergjetik të Ashtes. Këto masa për HEC-in e Ashtes janë zbatuar gjatë fazës së zbatimit të projektit dhe gjate fazes se operimit dhe projekte të tjera specifike të integruar në kuadrin e aktiviteteve të MMS. Masat zbatohen brenda moduleve kryesore dhe në përputhje me programin kryesor të zbatimit të projekteve. MMS ndjek një Vlerësim të Ndikimit Mjedisor dhe Social të kryer për Projektin Hidroenergjetik të Ashtes.

MMS është e përbërë nga tre komponentë kryesorë, Mjedisi, Risistemimi dhe Zhvillimi Social dhe Marrëdhënie me Komunitetin.

Programi MMS i HEPP Ashta synon të jetë në përputhje me Standardet e Performancës mbi Qëndrueshmërinë Mjedisore dhe Sociale të Korporatës Ndërkombëtare Financiare (IFC). Qëllimi është të sigurohemi që programet MMS të zbatohen në atë mënyrë që të gjitha familjet e prekura nga projekti dhe komunitetet të kenë rifituar ose mundësisht përmirësuar standardet e jetesës si rezultat i projektit dhe si pasojë të bëhen përfitues të projektit.

Qëllimet e MMS:

- të identifikojë dhe zbusë ndikimet e mjedisore dhe sociale të projektit dhe të nxisë mundësi të qëndrueshme zhvillimi
- të marrë masa për zbutjen e ndikimit në mjedis për të minimizuar ndikimet e projektit në mjedisin natyror dhe të zhvillojë shërbime të infrastrukturës mjedisore për të shmangur efektet negative si për projektin ashtu edhe për grupet kryesore të interest.

Ndryshimet klimatike

Përqasja jonë

Përmes veprimtarive tona kryesore të biznesit, EA kontribuon në rritjen e gjenerimit të energjisë nga burimet e rinovueshme të energjisë. Kontributet kryesore të EA në një sistem energjie më të qëndrueshëm janë operacionet tona aktuale dhe aktivitetet e lidhura të tregut.

Rreziqet kryesore

Ndryshimet strukturore të motit do të ndikojnë drejtpërdrejt në vlerën e aktiveve të EA, pasi do të ndikojnë në gjenerimin vjetor të centraleve dhe në vlerën e fleksibilitetit që mund të ofrojnë centralet. Hidrocentralet janë veçanërisht të ekspozuar ndaj ndryshimeve klimatike. Moti më ekstrem mund të sfidojë edhe integritetin fizik të infrastrukturës sonë. Nga ana tregtare, ndryshimet në nivelet e reshjeve do të ndikojnë në prodhimin e centralit, dhe modelet më ekstreme të motit mund të rrisin vlerën e fleksibilitetit .

Statusi 2021

Ndryshimet klimaterike dhe operacionet e tregut
Një element kyç i procesit të administrimit të përditshëm të energjisë është parashikimi për prurjet e ardhshme dhe ndonjë pasiguri e lidhur me këtë. Këto vlerësime bazohen në vëzhgime historike gjatë disa dekadave. Seritë kohore sigurisht duhet të rregullohen në bazë të ndryshimeve klimatike për të siguruar një bazë të vlefshme për vlerësimin e prurjeve të ardhshme. Për EA, të kuptosh se si klima po ndryshon është me rëndësi për veprimtaritë tona të përditshme. VERBUND merr pjesë në disa projekte kombëtare dhe ndërkombëtare për të përmirësuar kuptimin e efekteve të ndryshimeve klimatike në burimet hidrologjike.

Kuadri rregullator dhe potenciali për reduktimin e emetimeve
Politikat klimatike kanë një ndikim të madh tek EA.Politikat klimatike dhe të energjisë janë gjithmonë e më shumë të ndërlidhura. EA si pjesë e grupit VERBUND ndjek nga afër zhvillimet në politikat klimatike kombëtare, Evropiane dhe globale për të vlerësuar ndikimin e politikave të tilla. Të kuptuarit e zhvillimit të energjisë së rinovueshme dhe teknologjive të lidhura me të është gjithashtu e rëndësishme, për shkak se kjo ndikon në ritmin e transmetimit të energjisë dhe pozicionin tregtar të EA. Për këtë arsye VERBUND investon burime të rëndësishme në analizën e tregjeve, për të pasur një bazë të fortë për vendimet e investimit dhe shfrytëzimit.

INFORMACIONI EKONOMIK

Etika e biznesit

Përqasja jonë

EA është e angazhuar për standarde të larta të sjelljes në biznes. Kodi i Sjelljes i grupit VERBUND përcakton pritshmëritë nga secili punonjës, dhe kërkesat tona strikte janë në një linjë me praktikat më të mira ndërkombëtare. Etika e biznesit është një përgjegjësi e vazhdueshme, e mbështetur nga një funksion qendror i pajtueshmërisë. Ne kemi në aplikim një program gjithëpërfshirës të pajtueshmërisë i cili mbulon fushat e korrupsionit, mashtrimit, pastrimit të parave, si edhe mbrojtjen e të dhënave personale dhe ligjit të konkurrencës.

Rreziqet kryesore

VERBUND kryen rregullisht vlerësime të rrezikut kundër korrupsionit për të gjithë Grupin. Procesi i administrimit të rrezikut është më I zgjeruar për vendet dhe projektet me rrezik më të lartë, dhe gjithmonë përfshin një kombinim të ekspertizës lokale dhe burimeve qendrore të pajtueshmërisë.
Rreziqet kryesore të korrupsionit lidhen me proceset e transaksioneve, prokurimeve dhe pagesave, përdorimi I agjentëve dhe ndërmjetësve, proceset e lejeve nga qeveria, dhe administrimi i palëve të interesuara lokale. Rreziqet veçanërisht varen nga teknologjia dhe lloji i biznesit në diskutim. Këto ngjyrime reflektohen në hartat e rreziqeve në njësi të ndryshme të biznesit.

Statusi 2021

Trajnimi dhe komunikimi
EA sigurohet që të gjithë punonjësit të jenë të mësuar me parimet e përcaktuara nga Kodi i Sjelljes dhe rregullat e brendshme të etikës në biznes. Ne menyre te vazhdueshme punonjesit e EA marrin pjese ne trajnime qe organizohen nga Grupi VERBUND.

Kontrolli i partnerëve të biznesit
Energji Ashta si pjesë e grupit VERBUND ka procedura të qarta, të detajuara për përballimin e rreziqeve të lidhura me palët e treta. Kjo përfshin një politikë për kontrollin e prejardhjes, klauzolat në kontrata dhe monitorimin e kryer për kontratat me rrezik të lartë. Të gjithë partnerët e biznesit me rrezik të lartë (duke përfshirë të gjithë agjentët) kontrollohen nja Njësia e Pajtueshmërisë. Rishikimet e kryera të integritetit përfshijnë vlerësim të strukturës së pronësisë (duke përfshirë pronarët përfitues), të lidhjeve me persona të ekspozuar politikisht dhe rreziqet e reputacionit të lidhura me palët e tjera.

Në vitin 2021 u ndërmorën disa nisma për të forcuar më tej procedurat dhe kontrollet e brendshme në lidhje me pajtueshmërinë. Këto përfshijnë zhvillime të mëtejshme të Sistemit të Parandalimit të Mashtrimit që përfshin një sërë kontrollesh në proceset financiare që synojnë parandalimin dhe zbulimin e mashtrimit. Ka pasur gjithashtu investime të rëndësishme në kontrollet e reja të mbrojtjes së të dhënave personale, si pjesë e zbatimit të Rregullores së Përgjithshme Evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR) dhe Ligjin Nr. 9887 datë 10.3.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Mbrojtja e të dhënave personale
EA ka përforcuar procesin duke aplikuar një mjet mbështetës dhe përputhjen me sigurinë IT dhe qeverisjen IT, rrezikun dhe kontrollin, duke e bërë procesin më eficient duke shkuar drejt një zgjidhje të unifikuar për vlerësimet e rrezikut në të gjitha nivelet. Gjithashtu ka pasur investime të rëndësishme në kontrollet e reja të mbrojtjes së të dhënave personale si pjesë e zbatimit të Rregullores të Përgjithshme Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR) dhe Ligjit Nr. 9887 të datës 10.3.2008 për "Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Taksat
EA ndjek një strategji tatimore e cila është parimore, transparente dhe e qëndrueshme dhe në përputhje me Kodin e Sjelljes së VERBUND. EA është e angazhuar të sigurojë pajtueshmëri të plotë me të gjitha detyrimet ligjore dhe të gjitha dispozitat e autoriteteve tatimore.
EA kryen transaksione në bazë të parimit të tregut dhe nuk angazhohet në marrëveshje fiktive tatimore dhe në mënyrë të vazhdueshme konsideron të gjitha implikimet e planifikimit tatimor. Për më tepër, i gjithë planifikimi tatimor është subjekt i një rishikimi të plotë dhe procesi aprovimi dhe duhet të:

- mbështesë veprimtari tregtare reale
- mbështetet në zbulimin e plotë të fakteve dhe rrethanave ndaj autoriteteve tatimore përgjegjëse
- mos përdorë regjime tatimore të cilat konsiderohen të dëmshme nga OECD apo BE

Grupi VERBUND ka një procedurë të vendosur për administrimin e rrezikut tatimor e cila lehtëson identifikimin e duhur, matjen, administrimin dhe raportimin e rrezikut tatimor

Raporti i Drejtimit te Brendshem

2021

Drejtimi I Brendshëm

Kontrolli dhe drejtimi efiçent dhe transparent i biznesit përbën bazën për krijimin e një vlere afatgjatë për pronarin, punonjësit, palët e tjera të interesuara dhe shoqërinë në përgjithësi, dhe si rezultat, kontribuon në krijimin e vlerave të qëndrueshme dhe të përhershme. Shpërndarja e roleve frymëzon besimin mes palëve të interesuara përmes parashikueshmërisë dhe besueshmërisë. Komunikimi i hapur dhe i arritshëm nga shoqëria siguron se Shoqëria mban një lidhje të mirë me shoqërinë në përgjithësi dhe me të gjithë palët e interesuara të ndikuara nga veprimtaritë e shoqërisë.

o Veprimtaritë

Objektivi i EA është të operojë objektet energjetike dhe të kryejë operacionet përkatëse. EA është e regjistruar në Shqipëri dhe struktura e saj drejtuese bazohet në legjislacionin shqiptar për shoqëritë. EA është gjithashtu subjekt i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) në lidhje me detyrimet e shoqërisë për licensimin.

o Kapitali

Kapitali aksioner i EA arrin në 12,460,176 mijë lekë. Aksionet e shoqërisë zotërohen nga Ashta Beteiligungsverwaltung GmbH. Komiteti i Aksionerëve ka në fokus të vazhdueshëm përshtatjen e objektivave, strategjisë dhe profilit të rrezikut të shoqërisë me situatën e kapitalit të shoqërisë.

Komiteti i Aksionarëve

Kompania drejtohet dhe mbikëqyret nga një Komitet i Aksionarëve i përbërë nga 4 anëtarë. Komiteti i Aksionarëve zgjedh nga anëtarët e tij një Kryetar, i cili do të kryesojë dhe drejtojë debatin gjatë mbledhjeve të Komitetit të Aksionarëve.

o Fushëveprimi i Komitetit të Aksionarëve

Kompania drejtohet dhe mbikëqyret nga një Komitet i Aksionarëve i përbërë nga 4 anëtarë. Kryetari i Komitetit të Aksionarëve emërohet nga VHP.

o Drejtorët e Manaxhimit

Drejtorët e Manaxhimit drejtojnë veprimtarinë e përditshme të biznesit të Shoqërisë dhe e përfaqësojnë atë ndaj palëve të treta. Drejtorët e Manaxhimit i raportojnë Komitetit të Aksionarëve në lidhje me zbatimin e politikave të biznesit dhe në rast të përmbylljes së transaksioneve me rëndësi të veçantë për ecurinë e Shoqërisë.

o Asambleja e Përgjithshme

Komiteti i Aksionarëve ose Drejtorët e Manaxhimit nuk mund të marrin asnjë vendim, pa miratimin paraprak të Asamblesë së Përgjithshme për çështjet që kanë të bëjnë me:

- çështje lidhur me aksionet (ose titujve të konvertueshëm në aksione) të Shoqërisë;
- ndryshime në Aktet e Themelimit të Shoqërisë;
- shitje të plotë ose të një pjese të rëndësishme të biznesit të Shoqërisë;
- ndryshime madhore në natyrën ose objektivin e biznesit të Shoqërisë;
- emërimi (ose shkarkimi) i audituesve të Shoqërisë;
- aplikimin e Shoqërisë për likuidim, falimentim apo riorganizim sipas ligjeve të likuidimit ose veprimeve të ngjashme;
- Miratimin e pasqyrave financiare të shoqërisë dhe të Raportit të ecurisë së veprimatrisë dhe drejtimit te brendshëm
- shpërndarjen e fitimeve vjetore të Shoqërisë; dhe
- cdo çështje tjetër që ka nevojë për miratimin paraprak të Aksionareve sipas detyrimeve të legjislacionit shqiptar.

Menaxhimi i rrezikut dhe kontrolli i brendshëm

Koncepti i kontrollit të brendshëm përfshin pajtueshmërinë me vlerat bazë të shoqërisë dhe me udhëzimet për etikën dhe përgjegjësinë e korporatës. Funksione të rëndësishme për të siguruar që administrimi i rrezikut dhe kontrolli i brendshëm janë një pjesë e integruar e veprimtarisë së EA përfshijnë auditimin e

brendshëm të Grupit, funksionin e pajtueshmërisë, funksionin e rrezikut të Grupit, njësinë e Rishikimit të Investimeve të Grupit dhe kontrollin e brendshëm të Grupit në lidhje me raportimin financiar.
Administrimi i rrezikut është një pjesë përbërëse e të gjitha aktiviteteve në organizatë dhe në procesin e marrjes së vendimeve. Ai mbështet vendimmarrësit të vendosin prioritete në veprimet e tyre. Drejtuesit në të gjitha nivelet e organizatës janë përgjegjës për administrimin e duhur të rrezikut. Administrimi i rrezikut është i rregulluar nga rregulla dhe udhëzues. Ndjekja dhe administrimi i rrezikut janë të inkorporuar në operacionet e përditshme të biznesit. Administrimi i rrezikut dhe kontrolli i brendshëm janë pjesë përbërëse e punës së Komitetit të Aksionerëve.
Komiteti i Aksionarëve duhet të sigurohet që Drejtorët e Manaxhimit:

- të kenë përcaktuar instruksione dhe udhëzime të qarta se si do të vendosen në praktikë administrimi i rrezikut dhe kontrolli i brendshëm nga Shoqëria
- të kenë ngritur procese dhe funksione të përshtatshme për kontroll
- është siguruar që administrimi i rrezikut dhe kontrollit të brendshëm është kryer, dokumentuar, monitoruar dhe ndjekur në mënyrë të kujdesshme

Sistemi i menaxhimit të grupit VERBUND përcakton rregullat kryesore të Grupit dhe siguron një mjedis të shëndoshë kontrolli për përmbushjen e qëllimeve dhe synimeve të menaxhmentit. Funksioni i rrezikut i Grupit është përgjegjës për kuadrin e përgjithshëm të administrimit të rrezikut dhe monitoron rreziqet e përgjithshme në nivel Grupi.

○ Auditimi i shoqërisë

Funksioni i Grupit për auditimin e shoqërisë është një funksion i pavarur i cili ndihmon Drejtoret e Manaxhimit dhe drejtimin lokal në vlerësimin nëse rreziqet kryesore administrohen dhe kontrollohen mjaftueshëm. Qëllimi i Auditimit të Shoqërisë është të zgjerojë dhe të mbrojë vlerat organizative duke mundësuar siguri objektive dhe të mbështetur në vlerësimin e rreziqeve, këshillim, dhe informacion lidhur me drejtimin e organizatës, administrimin e rrezikut dhe kontrollin e brendshëm.
Puna e auditimit duhet të kryhet në përputhje me Standardet e Auditimit të Brendshëm (SAB).

○ Sistemi i parandalimit të mashtrimit

EA si pjesë e grupit VERBUND ka një sistem për parandalimin e mashtrimit për të shmangur dhe sinjalizuar mashtrimin në procese të lidhura me prokurimin, kontabilitetin, tatimet dhe thesarin.Sistemi i parandalimit të mashtrimit është në zhvillim të vazhdueshëm.

○ Informacioni dhe komunikimi

Çdo vit, EA i dorëzon dokumentet financiare prane Qendrës Kombëtare të Biznesit.
EA thekson komunikimin transparent me të gjitha palët e interesuara. Informacioni që kompania i jep pronarit të saj dhe palëve të tjera të interesuara duhet të sigurojë detaje të mjaftueshme për të lejuar një vlerësim të vlerave themelore të kompanisë dhe ekspozimit ndaj rrezikut. Raporti i Performancës dhe Drejtimit të Brendshem është përgatitur edhe në përputhje me nenet nr. "17" dhe nr. "19" i Ligjit për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare nr. 25/2018, datë 10.05.2018. Raporti është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme.

○ Audituesi

Asambleja e Përgjithshme emëron auditorin në bazë të propozimit të Drejtorëve te Manaxhimit dhe përcakton tarifën e auditorit. Auditori shërben derisa të emërohet një auditor i ri.
Komiteti i Aksionarëve informohet mbi pikat kryesore të raportimit të auditorit.

Treguesit kryesorë financiarë

Pasqyra e fitimit ose humbjes	Njësia	2021	2020
Të ardhurat bruto nga aktivitetet e shfrytëzimit	mijë Lek	2,300,441	1,449,324
Të ardhura neto nga aktivitetet e shfrytëzimit	mijë Lek	1,292,273	351,408
Fitimi para interesave, tatimit, amortizimit dhe zhvlerësimit (EBITDA	mijë Lek	2,074,797	1,133,375
Zëra financiarë neto	mijë Lek	(396,264)	(915,221)
Pasqyra e pozicionit financiar	mijë Lek		
Prona, makineri dhe pajisje dhe aktivet jo-materiale	mijë Lek	16,958,862	17,737,686
Aktivet totale	mijë Lek	18,936,504	19,279,504
Kapitali	mijë Lek	7,412,553	6,545,495
Flukset monetare	mijë Lek		
Flukset monetare të përdorura në aktivitete investuese	mijë Lek	(3,884)	(11,536)
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	mijë Lek	226,794	73,898